

THE USE OF THE ALBANIAN WORD AND PHRASE STRUCTURE IN RUDOLF MARK'S POETIC BOOK "RRATHË TË BRENDASHKRUAR"

PËRDORIMI I FJALËS SHQIPE DHE STRUKTURA E FRAZËS NË LIBRIN POETIK „RRATHË TË BRENDASHKRUAR“ TË RUDOLF MARKUT

Klotilda HARKA¹, Emrie KROSI²

¹ Department of Linguistics, Faculty of History and Philology, University of Tirana

² Department of Linguistics, Faculty of History and Philology, University of Tirana

*Corresponding author e-mail: klotildaharka@gmail.com

Përmbledhje

Kohët letrare brendashkruhen, jo vetëm si vibrime jehonash të ndërsjella nëpër kohë. Ato janë jo vetëm “skena” të jetës sonë në marrëdhënie me përditshmërinë, pra si një marrëdhënie mes tekstit dhe lexuesit, jo vetëm në konceptin e autorit që lidhet me traditën letrare (autori gjurmon që në fillimvitet ‘70), si një *shprehje differentiane*, duke riprodhur një perceptim ndjesor, jo vetëm me faktin e vetëdijes letrare në vazhdimësi, por edhe si “*shkrirje idesh të largëta*”, (Spurgeon: 1935), se “psikoanaliza” e lexuesit sociorealist, përjashtonte çdo lloj organizimi brendatekstor, që merret me tekstin, se leximi “*është rikrijim identiteti*”, (Holland: 1968) ku shfaqja dhe matja e koherencës semantike me koncepte të njohura të estetikës, quhet si një “distancimi estetik” dhe në “kuadrin e formës”.

Lexuesi është “pikë referimi” për tekstin, se “*lexuesi i nënkuptuar është aktiv dhe pasivo-aktiv*”, (Iser: 1976), sepse janë strukturat e tekstit ato që drejtojnë lexuesin, por fundja distanca kohore, *si marrëdhënia e domosdoshme me të vërtetën*, se kuptimi dhe vetëdija e së kaluarës (së poetit), është jo veprim i subjektivitetit të personit, “*por vendosja e personit brenda procesit të traditës, në të cilën e shkuara dhe e tashmja shkrihen vazhdimisht bashkë*”, (Gadamer: 1965). Ndërkëmbimi i brezave të lexuesve, ku nocioni i horizontit mes të shkuarës dhe së ardhmes ndjek edhe aspektin historik, (një vijimësi kohore), pa tejkaluar “hapësirat boshe”, për lexuesin e djeshëm dhe të sotëm, “*nëpërmjet horizontit të pritjes*”, (Jauss: 1982), të lexuesve të vjetër dhe të rinj, për një lexim ndryshe, për veprën e Rudolf Markut.

Fjalët kyçe: Rrathë, poezi, kohë, vend, maskaradë, fat, atdhe, çmitizim, parabolë.

1. Hyrja

Libri me poezi “**Rrathë të brendashkruar**”, i Rudolf Markut, është konceptuar në katër pjesë të emërtuara pjesë të brendashkruara: termi brendashkrim, në eptimin parësor (të shkruar brenda), lexuesi rishpalon një palimpsest, ku poezia hapet në rrathë si një nga format e përpunuara në kohësi, si një klithmajë në kërkim të “ndërgjegjes së kohës”, tek poezia “*Vendi im*”, (Marku: 2020); *emri yt ende nuk është shkruar/.../Askush nuk na e thotë vendin ku jemi/.../Ëngjëlli i Historisë që nuk na thotë as vedin ku jemi, O vendi im*, f.2, poeti mbruhet jo me dromcka mbijetese, por në vertikalishtin kohor mes Qiellit dhe Tokës, inercia e “maskaradës së fatit” ka humbur peshë.

➤ **Trishtimi është në shkallët tona:** (“dekostruktimi” mitik dhe biblik i trishtimit dhe (përtej)vdekjes, në “ovalen” e brendashkrimit të parë), janë poezitë: “**Kurrë nuk do të mbërrij në Tiranë**”, “**Të vdesësh në San Françisko**”, “**Argonautët**”, “**Sa shpejt**”, “**Duino**”, “**Teatri Globus, Southwark**”, “**San Donato, Milano**”, “**Trishtim**”, “**Në varrin e Charlemagne-it**”, “**Për E. B**”, “**Deti**”, “**Një Itakë tjetër**”, “**San Sebastian**”, “**Të kryqëzuarit zbresin në Golgotë**”, “**Infreno**”, “**Aleksandri**”, “**Këpucari plak**”.

Te dekostuktosh trishtimin e “humbjes” të atdheu tënd, në kërkim të lirisë, se poezia sipas Oktavio Paz , “*lind nga dashuria për të rijetuar jetën në vargje*”, në poezinë, “**Kurrë nuk do të mbërrij në Tiranë**” nëpërmjet vargjeve: *shkapërcej male, lugina, hone të frikshme,/I bie mepërmes Mesdheut, Adriatikut, Jonit,/ Por nuk arrij në Tiranë/.../Sepse trishtimi nuk qenka gjeografi/Sepse trishtimi nuk qenka vend*, f.5, (Idem, Marku), udhëtimi poetik me shpërfaqje gjeografike, duket një ujdhesë në stacionin e askundit, në kërkim të *atdheut të humbur*, them atdheu i humbur, se përsëri brendashkrimi i rrethit të udhëtimi në trishtimin “gjeografik” me shtresëzim të ngjeshur rrëfimi, me një “*narracion të mirëfilltë dhe subjekt i ndërlikuar*”, (Shaplllo: 1990), lidhet me dikotonominë:

a) *Çmitizimi i trishtimit: sepse trishtimi nuk qenka vend/sepse trishtimi nuk qenka gjeografi*, trishtimi si metaforë ripërsëritëse, një *figurë ekspansive*, si dominues kryesor i mendimit poetik, me një *element modifikues*, **trishtim** me fjalët çelësa, [vend/gjeograf], duke “ndërvepruar” mrekullisht estetikisht. Vetëm metafora e trishtimit lidhet me tri parabola:

➤ *Parabolë e kërkimit kulturor*, në vetë titujt që shpalos poeti kërkon “këpucëgrisur” nëpër tempujt e heshtur, por aspak të harruara të kujtesës njerëzore kulture, poezitë: “**Duino**”, “**Teatri Globus, Southwark**”, “**San Donato, Milano**” etj., në përballjen me të shkurën dhe të sotmen, vargjet: *në ledhet e thepisura të Kështjellës së Duinos/terori m’i zgjat duart e veta miqësore/.../kemi ardhur këtu në Oqeanin Paqësor*, f.1, hapësira oqeanike është frika, koha, pushteti, ujësia, ndarja dhe bashkimi, një “reliev kontinentesh”.

Në poezinë: “**Teatri Globus, Southwark**”, maratona e dilemave të mëdha shekspiriane për mbarë njerëzimin në çdo kohë, “të jesh apo të mos jesh, (to be or not to be)”: *e di kotësinë e Teatrit Globus,/ Këtu buzë Tamizit (Kisha e Shën Palit),/Prej kohësh nuk njeh meshë për shpirtin e Hamletit;/Sonte do të shfaqet Makbethi: një version afrikan*, f.12, duke defamiljalizuar tmerrin urban dhe absurdin e ekzistencializmit të njeriut, nuk e tëhuajëson, por herë-herë, rendit detaje të “zhvillimit urban” herë sendërton dhe shprish, trajtat e mirazheve reale, me detaje të ftohta, të një trajktoreje gjithëkohore, njëjtësuar me vargun eliotian; **Tamiz i dashur**, *shko i qetë gjer në fund të këngës sime/nimfat shkuan*, (Eliot: 2017), bëhet kapërcimi nga diskursi kulturor në atë mitologjik, **nimfat**, (Eliot-i) dhe diskursi fetar/biblik, **Kisha e Shën Palit**, (Marku), ëdhtë si një prerje, në ftohtësinë e një kronikani shëtitës: *Milano. Alpet nuk janë larg prej këtu, /Por mjegulla rri e fshehur, e ndrojtur, e bardhë,/Në shoqëri ujërisht që i ulërijnë Hënës,/presin veç çastin për*

t'iu vërsulur qytetit, f.13, duke epituar mjegullën, në formë enumeracioni, *metaforat e thella*, kthehen në epitete metaforike, : [*mjegulla e fshehur,/mjegulla e ndrojtur,/mjegulla e bardhë*].

2. Parabola në poezinë e Rudolf Markut

➤ *Parabolë e kërkimit mitik*, me poezitë: “*Të kryqëzuarit zbresin në Golgotë*”, të kryqëzuarit zbresin Golgotës/ Në muzg vonë. Pak plaçka/.../ Nuk i njuh askush. Pandehën se *ishin Krishti*/.../Me jetën tonë? Tashmë **Ponc Pilati** i ka larë duart f.23, apoteoza e ekzistencializmit njerëzor, na tregon se udha e njeriut është e njëjta *mëkatore dhe Antikrisht*, ku Ponc Pilati, (mund të quhet edhe *eufemizëm*) si gjykatës gjakësor, ka larë duar edhe me jetën tonë, se jemi të “kryqëzuar” nga *gabimet tona njerëzore*, duke përsëritur golgotat tona, ashtu si Krishti, “*e morën pra, Jezusin. E Zoti, duke e mbartur vetë kryqin, u nis drejt vendit të Kafkës, hebraisht Golgota*, (Gjoni. 19,17).

Edhe poezia tjetër, “*Infreno*”, në vargun: *shoh Porta e Ferrit, që mbyllen ngadalë/në anën tjetër të Tamizit*, f. 24, poeti padashur nuk e shmang dot ferrin që kemi brenda vetes sonë, ferri që na djeg të ardhmen, apo edhe ferri që i “dogji” të shkuarën poetit rebel, në “*lëmin e poezisë bashkohore*”, (Marku: 1987), që lexuesi të vetëperceptojë, të vetëjetësojë natyrshëm edhe dilemat e tij njerëzore: *mungesat, ndjesitë, të fshehtat, ankthin, shpresën, frikën, padurimin, shqetësimin*, si dhe një përjasje me **Ferrin**, “*Komedia Hyjnore*” (Alighieri: 2004) të kllas atje ku i thonë qytet-zezonë/të kllas atje ku dhimba s’ka kufi/të kllas te bota e bjerrun përgjithmonë, (F, k.III.v, I-III), duke udhëtuar drejt Itakës në poezinë, “*Një Itakë tjetër*”, vargjet: *në ditën e nesërme pas mbërritjes në Itakë/Pasi bëri dashuri me Penelopën/Pasi lau rrobat tërë pluhur dhe qepi sandalet e grisura/Pasi foli gjatë me Telemakun/.../ Më të pathyeshme ndaj zemërimit të Poseidonit/Më rezistente ndaj furive të Polifemit/Më të shurdhët ndaj joshjes së sirenave*, f.20, na kujton një tjetër Itakë, përtej Itakës mitike të Odisesë, Itakën e “mohuar” të “lirikut dhimbjes” shqiptar; Rreshpjen, “*Duke kërkuar Itakën*”, (Rreshpja: 2016), në tjetër poet i arealit të gegnishtes Rudolf Marku, që me të drejtë quhet “*udhëtari eksizencilist*” i poezisë moderne shqipe. Përsëritja e *anaforave*, [*pasi/më të*], e qartëson kumtin poetik, duke e “fortifikuar” stilistikën letrare.

➤ *Parabolë e kërkimit gjeohapësinor*. Hapësira në letërsi, mbetet hapësira në tekstin që kemi përpara, ku ne mbetemi pjesë e përcaktimit të asaj lëvizjeje që na sugjeron autori, meqenëse historia është e përjetuar prej tij. Kjo hapësirë, dëshmon dhe krijon kohën e vet vetëm në fund, pasi kemi përjetimin e leximit: *nuk ishte e lehtë të vështroja horizontet e largëta/Nga bregu i detit./Brigjet e Italisë, Francës, Spanjës/ Amerikën e largët a Saharanë e pluhurt e të shkretë*, f.14, poezia “*Trishtim*”, se “*fjalët mund të na shtynë të përfytyrojmë*”, (Eco: 1979), duke nënkuptuar përgjegjësinë e lexuesit, se hapësira nuk është thjesht një gjeografi apo shpejtësi, por perceptim. Perceptimi dhe “përfytyrimi” i udhëtimit gjeografik, nga Italia, Franca, Spanja, Amerika, Ishulli i Kruzos, Muri i Madh etj., kjo hapësirë gjeokontinentale, del dhe në titujt e poezive: “*Aleksandri*”, “*Amsterdam*”, “*San Sebastian*”, poezi të shenjuara në fund.

Harta e shtirjeve gjeografike nuk është vetëm e brendshme, por edhe e jashtme, që nënkupton jo një hapësirë të ngushtë, p.sh. dhomë, *dhomën e Jozef. K* të Kafkës, nuk mund të themi se është hapësira zero, por një “lojë” imagjitative “*kur lexuesi qartësisht nxit imagjinatën ose “plotëson rrjeshta bosh” të pathëna nga autori*” (Ingarden:1973), një imagjinatë lëvizëse, (se hapësira gjeografike është fizike në këtë cikël poetik), por “ndërrhyrja” e lexuesit, tek poezia, “*San Sebastian*” f. 22, është Mança e Don Kishotit, ajo hapësirë gjeografike, tashmë është një guidë turistike, ku imazhet e lexuesit lidhin personazhet e romanit, me hapësirën gjeografike, kur lexon vargun e fundit: *unë guxoj aq shumë, nuk kam guxim t’i them askujt se i shoh vërtetë*, f.22, pra

hapësira, përshkrimi i rrethanave si një “shkarkim” të imagjinatës dhe perceptimeve tona mbi veprën letrare, e “pamundëson” frikën autoriale të “rrefejë” për Kishotin, Dulqinën, Sançon etj.

➤ *Parabola e kohës letrare*, vargu: *trishtimi më thotë se ende nuk e kam nisur udhëtimin!*, nga poezia “*Trishtimi*”, ndeshim një *prolepsë*, sheston faktet të së ardhmes, sepse udhëtimi është kohë, por një dimension i kohës së ardhme ku vargu pasardhës: *ndërsa ne ecim me makinë pa u ndalur si mëkat*, f.18 , është koha e tashme duke skicuar kohën, kemi një transferim të kohës “arratisje prej kohës”, për të ndërtuar një përfytyrim real të kohës, ose si një betejë ekzistenciale , por edhe si një çelës i “kodeve” të transformimit të kohës në një kohë tjetër, ashtu si tek poezia: “*Amsterdam*”, vargu: *duke ecur deri vonë, shumë larg, larg/U vonua/.../dhe ecja, ecja, ecja kurrë pa fjetur*, f.42.

3. Koncepti i kohës dhe çmitizimi i vdekjes në vargun e tij

Koncepti i kohës trajtohet me mjeshtëri nga Rudolf Marku si më poshtë:

a) *Koha në marrëdhënie me frekuencën e saj* , “zgjatja” në tre mënyra:


- *rendi* ([*duke ecur*] koha e tashme).
- *përcaktesa e largësisë*, ([*shumë larg/larg*] koha e ardhme),
- *zgjatja e frekuencave*, ([*dhe ecja/ecja/ecja*]), koha e shkuar, është një kohë “gjatësore” [*shumë larg*], dhe koha “gjerësore” [*dhe ecja, ecja*], se koha “në letërsinë artistike termi “kohë universale”[...]*si një kohë “gjatësore”, përkundër termit “kohë e përjetshme”, apo “gjithëkohë”, ku janë dy kuptimet gjerësore dhe gjatësore, është pak e vështirë*”(Cani: 2010). Në poezinë “*Migjeni*”, vargjet : *koha ka kohë që është zhbërë*, f.84, është një *prolepsë*, se rrëfen “në herë, n/h”(Pozzato:2005), një kohë e pakohë, që është koha letare.

Koha nuk është vetëm *e tashme e përjetshme*, (folja [*ec/ecur/ecja*] eptuar në kohët e saj lëvizëse, që del njëmbëdhjetë herë në tekst) bashkë me thyerjet e saj, koha subjektive dhe koha objektive “*ndeshim fenomenin e përfitimit të kohës së katërt ose atë që quhet “dimension i katër prustian i kohës së kthyer në shumë “momente të tashme”, që lidhet me një logjikë jashtëkohore*”, (Rugova: 2005).

b) (Ç)mitizimi i vdekjes, me poezitë: “*Të vdesësh në San Françisko*”, “*Në varrin e Charlemagne-it*”, “*Të vdekurit*”, vdekja si metaforë, del pothuajse në tërë tekstin, me gjashtëdhjetë e tetë herë (68) vetë fjala [*vdiq/vdes/vdekja/ të vdes/të vdesësh/të vdekurit vdekatar*] është eptuar në shumë forma, por më shumë [*si folje kalimtare, veta III*], [*vdekja/emër*], [*vdekatar/emër i gj.mash.*], sidomos tek poezia “*Të vdesësh në San Françisko*”, vargjet: *Të vdesësh në San Françisko/Nuk është gjë e re. Shandor Marait, megjithatë , iu desh/.../tek ecte i vetëm në Muir Wood/Ah!, vdekja,vdekja!/Vdekja qan, lehtë, pa ngushëllim/sa e vështirë qenka të ngushëllosh vdekjen vetë*, f.6., poeti e ka përmendur këtë fjalë shtatë herë (7) bashkë me titullin e një tjetër poezie: “*Të vdekurit*”, që mund të paralelizohet me librin egjiptian për të vdekurit, “*Libri i të vdekurve*”, (Budge: 2011), si një mesazh; se vdekja dhe jeta, janë pjesë e njerëzores! Poezia tjetër, “*Në varrin e Charlemagne-it*”, me dedikime për miqtë e tij, (Açka dhe Zogaj), *varri* si një lloj *antonimie me vdekjen*, me formën më përmbajtësore me “*strukturë semiotiko-narrative*” (Greimas: 1966), në rrugëtimin gjenerativ, shtron edhe nivelin diskursiv, ku vetë instanca e thënies përzgjedh “*rrugëtimin figurativ*”, (Courtes: 1979).

Konfiguracioni diskursiv

Rrugëtime figurative



➤ **Sa shumë udhëtarë kanë ecur:** (“thyerja” e mitit të udhëtarit, në “kërkim” të Olimpik poetik, në “ovalen” e brendashkrimit të dytë), në këtë cikël poetik, poeti ka (ç)mitizuar, marrëzinë, profecinë, eksplorimin, nëpërmjet udhëtimit/lëvizjes, (vazhdimësia e foljes [ec]) nëpërmjet ciklit të poezive: **“Poetët”, “Alkimistët e Dashurisë”, “Drerët në Stokholm”, “Aktorët Shekspirianë”, “Moshatrët tanë”, “Migjeni”, “Një kujtim e John Donne”, “Nënat e poetëve” dhe “Nata e fundit e Ovidit në Romë”** ku sërish vdekja, shtegton me “mjeshhtërit e falës” së lartë, të bukur poetike, duke kërkuar Bukurinë Supreme, shpirtin e lirë nëpërmjet fjalës.

Bibla thotë: e para lindi fjala! Por fjala nuk ka më vlerë, ndaj edhe poetët vdesin, jo vetëm nëpër ëndrra, nëpër fjalë, për një grua, për një dashuri, poetët ecin nëpër, *male, muzgje, vjeshta dhe dimra*, shkojnë në ferr dhe ringjiten sërishmi në Olimp. Vargjet: *poetët nuk janë zot migratorë, nuk shtegtojnë në vende të largëta/Madje edhe kur vdekja i merr pa lajmëruar askënd,/ Na përshëndesin nga afër na thonë se nuk jemi larg/.../Poezitë e fundit që nuk kishin kohë t’i lexonim bashkë*, f.33, tek poezia **“Alkimistët e Dashurisë”**, me shënimin (miqve të mi poetë), janë poeziqë lidhen nga:

a) *Dekodimi i mitit të poetit*, kryefjala “poet/poetët”, që nga poezia **“Poetët”**, me vargun: *i shoh në shoqëri me Budin a Bogdanin, i shoh në kafene me Rilken a Whitmanin,/me Peson enigmatik a me vetë Shekspirin*, f. 34, duke i krahasuar me galaktikat e largëta, eksploron “planetin” e burrisë, me vargun: *që poeti*-eksplorator të kurorëzohet njëherësh *profet dhe burrë*, f.38, ku vetë *poetët* duke mëtuar në modelin e “përjetësisë” në një konkurrencë të ashpër drejt Unit, stërkëmbin vetveten. Tek poezia: **“Moshatrët tanë”**, vargu: *Moshatrët e mi, -Homeri, Budi, Bogdani/Safo dhe Kutali, Ovidi,Shekspiri, Servantesi/dhe ju që do të vini dyqind vjet më vonë*, f.40, tregon se shumë herë “madhështia e rreme” që kaplon ca pseudo/poetë dhe shkrimtarë, që vetëquhen “maja”, “vlëra”, “talente” etj., dhe;

b) *Dekodimi i “dhembjes së përjetshme”*, me poezinë: **“Nënat e poetëve”** dhe mbyllja e ciklit me fundvargjet: *kur Roma i përzë poetët e vet/është koha e duhur për t’i rënë Perandorisë*, f.46, në poezinë: **“Nata e fundit e Ovidit në Romë”**, diskursi poetik vazhdon, se çdo njësi kuptimore, se çdo njësi tekstore, “*në formë demonstrative S/Z*” (Barthes:1973) si një marrëdhënie të karakterit me “Sarrasinë” në dykuptimësinë e domethënies mes S / Z nëpërmjet modelit shtresor, duke i dhënë atë “*që teoria strukturaliste narratologjike e deklamonte si njëzëshmëri*” (Derrida: 1978).

4. Aksioma e kurbës melodike në vargëzimin e Markut

Prilli i zemrave tona: (“kantonima e sublimes”, të rremit dashuror, nëpër labirintet e moshës, në “ovalen” e brendashkrimit të tretë) vjen me poezitë: **“Ky është prilli i zemrave tona”, “Ti ishe një livadh i gjelbër”, “Nisjet”, “pas ikjes sate”, “një dilemë e qytetërimit”, “Fati është vdekat”, “Ishujt”, “krijimi iu botës”, “Ishte dashuria”, “Për Alam. P”, “Krilla e kujtimit tënd”, “Lutje”, “Baladë”, “E pse u dashka të jem në këtë qytet”, “Një ëngjëll më krahe të ndryshëm”**

Kantonima lirike ose dashurore, ashtu si “*odet lirike të In love*”, (Zogaj:2017) është tehuajizuar asgjë tjetër seçse aksioma e një kurbe melodike mbi/për dashurinë, larg elegjive (lekstisëse) “dëshpëruese” në paradhomën hyrëse me Evën, gruan e parë të botës të “dashuruar” me mëkatin e burrit, mëkatin e vuajtjes, mëkatin e pasardhësve, kanë një harmoni komunikimi, me “gjuhën e zemrës”, *o grua që të desha në fatkobin e kësaj bote*, f.51, tillon si një “betejë” për sundimin e territorit, deri përtej gjerdheve të zemrave. Ky “mirazhi” i gruas së dashurisë, është sa Biblioteka e Babilonisë, *puthjet e tua, trupi i lakuriqtë, gjoksi yt prej gruaje, flokët/ujëvarë a vetëtima që shkrepin, /Dhe instistkttet e mia që thërrasin me forcë seksin tënd;/Asnjë nga betejat e mëparshme nuk më kujtohen*, f.54, nga poezia “**Ti ishe një livadh i gjelbër**”.

Larg elegjive deklamative, larg melankolive, forma dhe struktura magjepsëse të një lirike ndryshe, ku *dashuria dhe dashurorja, dëshira dhe mungesorja*, ku *instiktet dhe seksi, plotmëria dhe sundimi* në alkiminë *mashkull/femër*, lëviz jo vetëm formave ovale të brendashkrimit, por aty strukturat “gdhendin” jo vetëm forma nga më të hershme të komunikimit, por mbështjellin me një mbulesë transparente, shpirtin e lexuesit, aq fine, aq të hollë, duke tëholluar si një simbiozë në dy poezitë, “**Ishte dashuria**”, “**Për Alma. P**”, “**Krilla e kujtimit tënd**”, në strofën katërvargore: *ishte dashuria-e pra, kishim rënë jashtë kohe/Nuk kishte as javë, as muaj dhe as vite,/nata shkëlqente nga dy globet e tua diellore/Ndërsa yjet na ndriçonin në mesin e ditës që ike*, f.62, vargu ab/ab, dhe fjalët e fundit me lidhje *asonance* (zanorësie), si një bukurtingëllim, [kohe/diellore] dhe çifti tjetër kundërvënës [vite/ikte]dhe poezia “**Baladë**”, vargjet: *të premtova gjërat më të pamundura në botë: /.../Ti më besove pa më pyetur as edhe një fjalë/.../Ti që vetë kurrë nuk më premtove asgjë*, f.67, një baladë dashurie, ku dikotomia foljore [premtim/besim] ndërlihdhet jo vetëm me folje statike, lidhja *konsonative* (bashkëtingëllorësia) nuk është vetëm ndërlihdhje asonantive,[e/i] bashkë me bashkëtingëlloren fundore[m] si rimë foljore, të japin “egon” e një ndjenje sublime.

Duke përdorur tenikat e gjuhës, jo vetëm të rimave dhe *asonancave të brendshme*, por edhe si dimension lëvizës, si njësi kuptimore, për të përforcuar jo vetëm rimat e mbrendshme dhe të jashtme [bardhë/ujëvarë] si kumt lidhës *asonancash*, bashtingëllon me *bashtingëlloren kërcitëse* [r], në vargjet e mëposhtme: *të premtova fustan bërë nga drita e hënës,/Një krehër prej shkume deti të bardhë, /Një karficë mes dy brigjeve të largëta,/për të lidhur flokët e shprishur një ujëvarë*, f.67.

Lirika e dashurisë si e parapëlqyer për poetin R.Marku, që në fillimet e veta (vitet’70-‘80), si tendencë për t’iu larguar temave të kohës, vetëm si lirika dashurore dhe jo erotike, larg *metaforave magjike dhe biblike*, për kohën ishin modreniste, *dëborërat e dimrit u shkrinë tani/ Ecën lumi me ujëra i mbushur/ Dhe prapë se si mu kujtove ti*, (Marku: 1980), duke ruajtur trajtat konkrete të trajtimit të ndjenjës, ashtu sikurse edhe përgjithësisht u ndërtuan vargjet me tipare konkrete dashurie, *shpesh herë kalon pranë meje një/ vajzë e qetë/ Me indiferencën e heshtjes së një fëmije*, (Marku: 1972), ku konfiguracioni diskursiv i poezive të Rudolfit, vërtitej rreth mungesës si motiv; ku uni lirik mban emrin e largimit të së dashurës.

Motivi i pritjes, si diskurs lirik, u ngrit mbi narracionin poetik ndërtuar në varg të lirë, jo më pjesë e dëshirës dhe pamundësisë, *nuk duhet të të shoh çdo ditë,/ Takoj njerëz të tjerë, shtrëngoj duart e tyre, /Përgjigjem tjetër për tjetër duke buzëqeshur mirësisht,/ Nganjëherë vetëm e vetëm nga mungesa jote*, (Marku: 1989), e njëjtë me izotonominë poetike të një dekade tjetër, *për të me thënë atë që terrori i ëndërrave ma ka pëshpëritur/ lehtë-lehtë:/Se tani, në yjet e largëta që kurrë nuk arrihen,/ka vite që më pret*, f.66, poezia “**Lutje**”.

➤ **Jemi ne, jo statujat**: (“prapëkthimi” në vetëdijen e nekrologjisë së ekzistencializmit bohem, në “ovalen” e brendashkrimit të katërt), me grupin e poezive të fundit: “**Jemi ne, jo statujat**”, “**Një shkëmb në det**”, “**Ditëlindje**”, “**Nuk është vonë**”, “**Malet**”, “**Vendi ynë që nuk është as yni**”, “**Një**

qytet i madh”, “Të vdekurit”, “Çfarë pashë sot në rrugë”, “Në kujtim të nënës”, “Dialog i pamundur”, “Loznim me historinë”, “Ju lutem, mos gjetët diçka të humbur?”, “Alpet” .

5. Katër kodet gjuhësore në përshkrimin e konceptit të pritjes

Këtë pjesë do ta ndajmë në katër kode:

a) *Kode/(de)kode të surreales së atdheut*, (atdheu si tempulli i shpresës dhe (mos)harresës), poeti na ka dhënë një shkëndijë të ekzistencializmit njerëzor, që kërkon “qenësinë” e tij, *jemi ne, të gjallët, që jetojmë njëherësh në fragmentet e jetës sonë*, f.75, se kotësia e jetës njerëzore kudo jemi dhe kundo ndodhemi jemi në kërkim të Asgjësë dhe shkojmë drejt Askundit. Jemi thjesht fragmente, jete, kohe, moshe, ëndrrash, *këtejmeta* dhe *matanëmeta*, jemi Qenie, por jemi edhe Hiçi.

“Qenia dhe hiçi”, (Sartri: 2011) ose neveria e dukjes, nuk është thjesht “shkak i vetvetes”, por ndërgjegjja që eksiton pavarësisht vetvetes, që shumë herë mund të themi jemi “hiç” por që edhe kjo rrjedh nga “qenia, jashtëvetvetes nga “psikologjia e turmës”, në kërkim të tempullit tënd të faljes, nëpërmjet vargjeve: *vendi ynë që nuk je as yni:/Kur të vijmë pranë shtiresh se nuk na njuh,/ Na i shqipton keq emrat, policët e tu na shohin me dyshim/.../Vetëm hajdutët e tu na presin me mirëseardhje të singertë!/ Ikim larg, sa më larg, por prapë nuk na harron;/Vendi ynë i braktisur nga engjët e historisë/ Si një këngë monotone gjinkallash në një pasdite vere* f. 82, kjo poetikë kaq e hapur nuk ka asnjë mistikë “spirituale” larg trilleve të “mallit nga kurbeti”, sheh një atdhe sa mungesor aq edhe të pranishëm, por gjithmonë bijtë e tij i zbon drejt Askundit dhe Hiçit.

Vendi ynë i braktisur nga engjët e historisë, ky varg a nuk është himni i pritjes së pafundme sikur Gogoja, për të ndodhur ndonjë mrekulli, por poeti nuk është “nihilist” në surrealizmin e atdheut të tij; *me këmbët në lumin Drin dhe torson e zhytur në/thellësitë e Paqësorit/Shohim sirenat e detit pa arritur kurrë të dëgjojmë këngën /e tyre/ Shohin nekrologjinë në mure pa parë kurrë të vdekurit*, f.76.


b) *Kode/(de)kode të (ç)mitizimit të vendlindjes* (malli për detin, varret, historinë) poeti i rikthehet miteve dhe mitologjisë, sirenat e detit, rikthimi tek mitet apo *sirenat shurdhuese* Karibla dhe Skilla, në varësi të mimetikës së lartë apo të ulët, *“një vargan mitesh të zhvendosura”*, (Fraj: 1990), në vazhdimësi të “mitit të vendlindjes” *doja të shihja floçkat që niseshim gjithnjë para meje/Duke lënë mbi një shkëmb jehonën e shurdhët të braktisjes*, f.77, (vetë floçkat janë qenie të bukura ujore në besimet popullore), por perceptimi poetik i vendlindjes nëpërmet (mit)marrjes dhe (mit)sjelljes, na hedh në tejkohësi, nga Sibilat e Eliot-it tek *“Këngët e Sibilave”*, (Bogdani: 2019).

Vizioni i historisë, “vizatohet” në Lisusin e lashtë, ku “deti i tij” në brigjet e Adriatikut, ndante “botën e lirë” matanë dhe botën e mbyllur shqiptare, nëpër mugëtirat e të kohës, vizaton *fëmijërinë, kujtimet, rininë, djalërinë, burrërinë*, që vjen nëpërmjet vargjeve; *shkoj në bregun e detit/Dhe hedh në thellësitë e ujërave/Lotët janë të njelmëta si/ujërat/Dhe deti është i kripur po ashtu. Kush mund ta dallojë/.../detin nga lotët/ E di se një lakrimore kurrë nuk duhet të qëndrojë e zbrazët,/.../Për gjërat e çmuara që mund të kemi në jetë*, f.89, në poezinë: *“Loznim me historinë”*.

c) *Kode/(de)kodet të (për)mallimit dhe mungesës mëmësore dhe atërore*, (hymn për mungesën dhe mallin) në mungesë të nënës që vdes; *pa lajmëruar askënd,/Nëna vdiq,/Nuk deshi të shqetësonte njeri/Mjaft ka bota hallet e saj, bregat/ Ajo iku, si të thuash, në majë të gishtërinjve*, f.86, tek poezia *“Në kujtim të nënës”*, kemi një Merso, që dënohet vetëm se nuk është në varrimin e nënës. Rrëfimtari “alla kamy”, në romanin e tij *“I huaji”*, për absurdin e njeriut dhe vdekjen, ashtu siç pranon Kamy: *“njoh edhe një të vërtetë tjetër: ajo më thotë se njeriu është i vdekshëm”*, (Kamy: 2018), edhe nënat e poetëve vdesin, mes “ftohtësisë së dhimbjes” së humbje së nënës, dhe pamundësisë për t’iu shmangur vdekjes, se *“njeriu absurd nuk e shpjegon botën por vetëm e përshkruan atë”* se njerëzit e pashpresë nuk i përkasin të ardhmes, ndaj duhet të “përballen me të tashmen”, se poezia *“Çfarë pashë sot në rrugë”* e tashmja e rastësishme e njeriut pavarësisht

moshës, rrudhave, thinjave, se lumturia, marrëdhënia, mirëkuptimi, besimi, respekti, dashuria nuk kanë moshë, *fare rastësisht i pashë/ Këtë mbrëmje të kapur për dore/Nuk doni t'ia dinin për asnjëri;/Qenë tepër , tepër pleq të dy*,f.85, pastaj vjen poezia “**Dialog i pamundur**”, tashmë kam arritur **moshën e babis tim/Pa asnjë ndrojtje, pa asnjë kompleks edipian,/E ftoj për një gotë në klub**. Është vonë, f.87, është thirrja e vatrës atërore, se djali në mungesë të babait quhet “shtylla e shtëpisë”, por bashkëbisedimi i vonë, me “një gotë”, duke anashkaluar “kompleksin e Edipit”, marrëdhënia baba-bir, (Pema e Gjakut), është “thyer” ashtu si lidhja nënë-bir (Pema e Tamblit)=Pemën e Jetës, që (ri)ndërton fabula e kësaj poezie.

d) Kode/(de)kode vertikale dhe horizontale, (perceptimi i kufirit të qiellores dhe tokësore), që nga poezia “**Një shkëmb në det**”, rrafshi horizontal tokësor , fillon me shkallëzimin ngjites në rrafshin vertikal: *pa arrogancë, por edhe pa ndonjë mirësjellje,/Hynë drejt e në shtëpi/Malet*. Shkundën në pragun e shtëpisë dëborën, f,80 poezia “**Malet**”, padashur poeti nuk ka zbuluar pikëpamjet e tij lidhore me konceptet e imazheve vetëburimore të (përmbajtes dhe formës), sepse përshkallëzimi rritës ngjitet me vargjet: *që qëndronin pa asnjë domethënie mes Qiellit e Tokës,/Më pranë qiellit, sipër reve,/Në sublimin e vetmisë plot hamendje...f. 92., (Alpet)*, në formën e këtij diagrami:



Perceptimi i poetit kalon çdo kufi, të tokësore drejt bashkimit me kufirin qiellor. Deti (uji) nëpërmjet shtyllave të (ajrit) Mali/Alpet shkojnë deri në shtyllën Sipërore (Dritës/Diellit), poezia ngjitet deri në horizontalitetin, si misioni poetik duke shënjuar veprim, lëvizje, mendim të lartë eseistik drejt një “arti të kulluar” apo *sui generis*, në formën e *katarsisit shpirtëror* në formën më natyrale të hirësisë së jetës:

*Në qytetin modern
shoh burra me dhurata ndër duar
që nxitojnë që ecin shpejt,
shoh edhe fëmijë në krahët e së ëmës
me një buzëqeshje të madhe sa një qytet, f.83.*

(“Në qytetin e madh”).

6. Përfundimi

Rudolf Marku nuk ka devijuar nga gjuha standarde, por një “përzgjedhje” gjuhësore qëllimisht estetike, nëpërmjet tingëllimit të fjalëve, strukturat e frazës, është ndërtuar më një rend të tillë fjalësh, me hierarki kuptimore, që nëpërmjet analizës stilistike të këtij vëllimi, është “purifikuar” jo vetëm identiteti i pjekur i autorit (tashmë të njohur), për përçimi tek lexuesi i sotëm, i një kumti të lartë autorial. Herë-herë, shohin përsëritje të vargjeve, për efekte stilistikore, në formë dyvargore apo edhe në ato pak poezi me rimë, larg përsëritjeve klishe të poezisë së sotme që keqtingëllon si tam-tame, me një mungesë totale të kulturës letrare-poetike, por edhe nga mungesa e kritikës së specializuar, nuk ia zbeh vlerat, nga “ndikimi” i lexuesit “virtual” në pamundësinë e “aftësisë përzgjedhëse”, se ky vëllim i ka të gjitha, si prozobinë e një arti të lartë të mirëshkruar, ashtu edhe gjuhëkodet duke tejçuar kumtin: se poezia e Rudolf Markut, duhet të jetë në majën e panteonit të letrave moderne shqipe.

Referencat

- [1]. Alighieri, Dante: (2004), *Komedia hyjnore*, përkth: Mark Ndoja, Tiranë.
- [2]. Barthes, Roland. (1973): *S/Z Rolan Barthes*, Editions du Seuil, Paris.
- [3]. *Bibla*, (Gjoni. 19,17).
- [4]. Bogdani, Pjetër: (2019), *Këngët e sibilave*, “Pakti”, Tiranë
- [5]. Bugde, W. Ernest: (2011), *Libri i të vdekurve*, përkth: Azem Qazimi, “Zenit”, Tiranë.
- [6]. Cani, Defrim. (2010): “*Dielli i vështirë” dhe koha e poezisë*, “OMBRA GVG”, Tiranë.
- [7]. Courtes, Joseph. (1979): *Introduzion á l’analyse narraive et discursive*, PUF, Paris.
- [8]. Derrida, Jacques. (1978): *Writing and Differenece*, London
- [9]. Eco, Umberto: (1979), *Lector in fabula*, Bonpiani, Milano
- [10]. Eliot. S. Tomas: (2017), *Toka e shkretë*, përk; Gentian Loloçi, “Aleph”, Tiranë.
- [11]. Gadamer, G. Hans: (1965), *Truth and Method*, London.
- [12]. Greimas, Algirdas. (1966): *Semantique structuarle*, Larouse, Paris.
- [13]. Holland, Norman: (1968), *The dynamic of Literary, Response*, Oxford.
- [14]. Iser, Wolfgang: (1976), *The akt of Reading: a Theory of Aesthetic Response*, London.
- [15]. Jauss, H. Robert: (1982), *Toward an Aesthetic of Reception*, Brighton
- [16]. Kamy, Albert: (2018), *I huaji*, “Fan Noli”, Tiranë.
- [17]. Marku, Rudolf: (1978), *Poezia dhe bashkëkohësia*, “Drita”, Tiranë.
- [18]. Marku, Rudolf: (1980), *Ti ke vetë emrin e stinës*, “Drita”, Tiranë.
- [19]. Marku, Rudolf: (1989), *Udhëtim nëpër vendin e gjërave që njohim*, “N.Frashëri”, Tiranë.
- [20]. Marku, Rudolf: (2020), *Rrathë të brendashkruar*, “Onufri”, Tiranë.
- [21]. Pozzato. P. Maria: (2005), *Semiotika e tekstit*, përkth. Dhurata shehri, SHBLU, Tiranë.
- [22]. Reshpja, Frederik: (2016), *Duke kërkuar Itakën*, “Princi”, Tiranë.
- [23]. Rugova, Ibrahim. (2005): *Strategjia e kuptimit*, “Rilindja”, Prishtinë.
- [24]. Sartre, P. Jean: (2011), *Qenia dhe hiçi*, përkth: Rexhep Hida, “Noli”, Tiranë.
- [25]. Spurgeon, Caroline: (1935), *Shakespeare’s Imagerz, and Ehatit Tells Us*, Cambrigde.
- [26]. Shaplllo, Dalan: (1990), *Poezia nëpër kohë*, Tiranë.
- [27]. Zogaj, Preç: (2017), “*In love” 101 poezi dashurie*, “Mapo Editions”, Tiranë